STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 7 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON KOHEZGJATJE PER LEJET SHTETERORE, RINOVIMET E LIÇENSAVE DHE PAGESAT PER BIZNESET E PREKURA NGA URAGANI SENDI (HURRICANE SANDY)

Kohëzgjatjet nga Autoriteti Shtetëror i Pijeve Alkoolike dhe Departamenti i Ruajtjes së Mjedisit ndihmojnë që bizneset të përmbushin afatet kohore

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot kohëzgjatjet e siguruara nga Autoriteti Shtetëror i Pijeve Alkoolike dhe Departamenti i Ruajtjes së Mjedisit për rinovimin e liçensave dhe kërkesat e lejeve për bizneset në rajonet e prekura të shtetit. Përveç kësaj, agjencitë shtetërore janë duke siguruar disa heqje të tarifave dhe kohëzgjatje për pagesa.

“Mijëra biznese u prekën nga shkatërrimi i shkaktuar nga Uragani Sendi (Hurricane Sandy) dhe agjencitë shtetërore duhet të ndërmarrin hapa për të siguruar se këto biznese mund të rihapen dhe të funksionojnë me sa më pak ndërprerje që të jetë e mundur,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Sigurimi i kohëzgjatjeve për kërkesat e lejeve, rinovimet e liçensave dhe pagesat do të ndihmojë që këto biznese të përmbushin afatet kohore për një rimëkëmbje të shpejtë.”

Kohëzgjatjet e Autoritetit Shtetëror të Pijeve Alkoolike për mbajtësit e liçensave të pijeve alkoolike

Autoriteti Shteteror i Pijeve Alkoolike (SLA) do të zgjasë periudhat e rinovimit për mbajtësit e liçensave të pijeve alkoolike në zonat e prekura nga uragani, në mënyrë që këto biznese të mund të përmbushin afatet kohore të paraqitjes së kërkesës dhe të pagesës. Mbajtësit e tanishëm të liçensave në Qytetin e Nju Jorkut dhe qarqet e Uestçesterit, Roklendit, Nasaut dhe Safolkut, që duhet të rinovohen në tetor dhe nëntor, do të marrin një periudhë automatike falje prej 60 ditësh pas datës së skadimit, gjatë të cilës mund të vazhdojnë të funksionojnë. Guvernatori gjithashtu njoftoi një zgjatje të afateve kohore brenda të cilave shitësit me pakicë mund të paguajnë shpërndarësit për dorëzimet e bëra përpara stuhisë.

Iniciativa të tjera të ndihmës që kanë lidhje me SLA përfshijnë:

• Zëvendësimi falas i liçensës - SLA do të sigurojë falas çertifikata të zëvendësimit të liçensës për ato të humbura ose të dëmtuara për shkak të Uraganit Sendi (Hurricane Sandy).

• Leje të Vitit të Ri - Afati kohor për kërkesën për "leje gjatë gjithë natës" për Natën e Vitit të Ri do të zgjatet për mbajtësit e liçensave në zonat e prekura nga 16 nëntor 2012 në 1 dhjetor 2012.

• Liçensa të përkohëshme - Bizneset që tani funksionojnë me liçensa të përkohëshme (leje të përkohëshme të shitjes me pakicë), mund të kërkojnë që këto liçensa t'u zgjaten për 30 ditë të tjera.

• Leje të veprimtarisë së veçantë – Sipas kërkesës, rimbursime të plota do të sigurohen për veprimtaritë e anulluara për shkak të Uraganit Sendi (Hurricane Sandy). Mbajtësve të lejeve që kërkojnë të riplanfikojnë një veprimtari do t'u jepen leje të reja pa asnjë kosto shtesë, pavarësisht nëse veprimtaria zhvendoset në një vend të ri.

• Letra të mangësive – Kërkuesit që paraqitën kërkesa gjatë javës së Uraganit Sendi (Hurricane Sandy) ose morën një letër të mangësive gjatë asaj kohe do të kenë 40 ditë, në vend të 20 rregullisht, për të korrigjuar mangësitë.

• Zgjatjet e Miratimit të Kushtëzuar - Çdo kërkuesi, kërkesa e liçensës e të cilit u miratua me kusht gjatë javës së Uraganit Sendi (Hurricane Sandy), do t'i jepen 60 ditë të tjera për të përmbushur kushtet e miratimit, me zgjatje të mëtejshme për t'u konsideruar sipas kërkesës. Kushtet tipike të miratimit përfshijnë marrjen e kompensimit të punëtorëve dhe policat e pa-aftësisë, autoritetin për të mbledhur taksat e shitjeve, çertifikatat e vendndodhjes dhe fotografi që tregojnë një mjedis është gati për t'u hapur. Në mënyrë të ngjashme, kushtet e miratimit për ndryshime do të zgjaten për 60 ditë të tjera.

• Shtyrja e ndëshkimeve civile - Mbajtësve të liçensave që kanë ndëshkime civile të pagueshme gjatë periudhës së 26 tetorit 2012 deri më 30 nëntor 2012 u jepet një shtesë tjetër prej 30 ditës nga data fillestare e pritshme.

• Zgjatja e kohës së shitësve me pakicë për të paguar shpërndarësit - Shitësit me pakicë do të kenë 15 ditë të tjera biznesi për të paraqitur pagesat pranë shitësave me shumicë për dorëzimet e bëra në zonat e prekura. Faqja në internet e SLA-së siguron datat e zgjatjes për secilën pjesë të industrisë (birrë, verë dhe pije alkoolike), në http://www.sla.ny.gov/.

Për informacion shtesë në lidhje me ndihmën që kanë lidhje me SLA për Uraganin Sendi (Hurricane Sandy) ose për të kërkuar një rimbursim ose një leje të përkohëshme, ju lutemi kontaktoni SLA në sandyrelief@sla.ny.gov ose telefononi (518) 474-3114.

Kohëzgjatjet e DEC për lejet shtetërore dhe pagesat për bizneset e prekura

Guvernatori Kuomo (Cuomo) njoftoi gjithashtu se Departamenti i Ruajtjes së Mjedisit (DEC) do të heqë pagesat dhe do të zgjasë afatet kohore të kërkesave për leje shtetërore për 30 ditë duke filluar që sot. Këto heqje do të zbatohen për bizneset në qarqet e Uestçesterit (Westchester), Roklendit (Rockland) dhe Oranxhit (Orange), Long Ajlënd (Long Island) dhe Qytetin e Nju Jorkut. Kjo do të ndihmojë ato biznese që të përmbushin afatet kohore për paraqitjen e kërkesave për leje për modifikime të vogla dhe rinovime, detyrimet në urdhërat e pranimit dhe pagimin e pagesave të rregulloreve.

Këto përpjekje të ndihmës për bizneset përfshijnë:

- DEC është duke dhënë një kohëzgjatje për paraqitjet e kërkesës për modifikime të vogla të lejes dhe rinovime të lejes.

- Agjencia është duke përgatitur një Urdhër të Përgjithshëm për të përcaktuar kërkesat që duhet të respektojnë prodhuesit e mbeturinave të rrezikshme, për të lejuar që mbeturinat e rrezikshme të krijuara nga dëmi i stuhisë të eleminohen siç duhet pa pësuar pagesa dhe taksa për një periudhë kohe të caktuar.

- Shteti do të zgjasë datën e pritshme për pagesat e rregulloreve, që përfshijnë pagesa për tonë të rregulluar të ndotësve të ajrit të nxjerra nga mjediset që i nënshtrohen programit të lejes së funksionimit të Titullit V.

- DEC është duke zgjatur afatet kohore për respektimin e detyrimeve në urdhërat e nxjerra nga agjencia mbi pranimin e reaguesve. Përveç kësaj, DEC do të riplanifikojë çështjet rutinë në kalendarin e seancave.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418